



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:220263

Datë: 28.08.2024

Numri i dokumentit: 06093325

2022:220264

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik, si gjykat jo kontestimore e shkallës së parë, gjyqtari Burhan Berisha, si gjyqtar individual, me basgkëpunëtoren profesionale Teuta Bega, në lëndën jo kontestimore të propozueses H. S. , nga fshati ..., Komuna Shtërpcës, të cilën me autorizim e përfaqson avokat N. R. nga Kaçaniku, duke vendosur lidhur me konstatimin e vdekjes së personit Sh. (L.) D. , nga fshati ...-Kaçanik, pas mbajtjes së seancës gjyqësore më datën 20.08.2024, ndërsa me datën 28.08.2024 bëri përpilimin me shkrim të këtij :

A K T V E N D I M

I. APROVOHET si i bazuar Propozimi i propozueses H. S. , nga fshati ..., Komuna Shtërpcës dhe VËRTETOHET se :

Sh. D. nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut, nga i ati L. dhe e ëma N., ka vdekur më datën 10.11.1982, në fshatin ..., Komuna e Kaçanikut,

II. DETYROHET Shërbimi i Gjendjes Civile në Kaçanik që të bëjë regjistrimin në librin amë të vdekjes, sipas këtij aktvendimi.

III. Ky aktvendim është i formës së prerë që nga data 20.08.2024, ndërsa shpenzimet për taksë i ka paguar pala propozuese

A r s y e t i m

Propozuesja në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik më datën 25.01.2022, e ka dorëzuar propozimin, me të cilin ka kërkuar që të konstatohet vdekja e Sh. D. nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut sepse i njejti kanë vdekur dhe nuk shtë regjistruar në Librin Amë të të Vdekurve (LAV).

Gjykata e ka caktuar seancë gjyqësore për datën 20.08.2024, në këtë seancë i autorizuari i propzueses, ka deklaruar se mbetet në tërsi si në propozimin me shkrim dhe i ka propozuar gjyaktës që propozimi të miratohet si i bazuar dhe të vërtetohet se Sh. D. nga fshati ... Komuna e Kaçanikut, ka vdekur më datën 10.11.1982, në fshatin ... Komuna e Kaçanikut, ka theksuar se tani i ndjeri nuk është regjistruar në librin amë të gjendjes civile të vdekjes dhe vdekja e tij nuk mundë të provohet me vertetimini nga Bashkësia Islame në Kaçanik me numer protokoli 160/22, i dates 24.10.2022.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen e plotë faktike dhe gjykuar në mënyrë të drejtë ne këtë qështje jo kontestimore të konstatimit të faktit të vdekjes, gjykata bëri administrimin e këtyre provave edhe ate i lexoi: vrtetimin e leshuar nga Bashkësia Islame Kaçanik, me nr. Protokoli 160/22, I dates 24.10.2022, kopja e leternjoftimit per propozuesen, pa pyetje dhe pa vrejttëje.

Pas vlersimit me kujdes dhe profesionalizëm të secilës prove veç e veç dhe të gjithave bashkarisht, e në bazë të dispozitave të nenit 8 të LPK-së,si dhe bindjes së lir të gjykatë,kjo gjykatë për këtë qështje jo kontestimore vërtetoi këtë gjendje këtë gjendje faktike:

Personi Sh. D. nga isha fshati ..., ka vdekur më datën 10.11.1982, në fshatin ..., Komuna e Kaçaniku, i njeti nuk është regjistruar në librin amë të të vdekurve.

Sh. D. ka vdekur më 10.11.1982, në fshati ..., Komuna e Kaçanikut, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga deklarata e propozueses dhe nga vertetimi i leshuar nga Bashkësia Islame kaçanik,

i dates 24.10.2022, ku konstatohet se Sh. (L.) D. nga fshati ..., ka qene anetar i Komunitetit Musliman ne kaçanik dhe eshte varrosur ne fshatin ... me date 10.11.1982.

Gjykata pas analizimit të propozimit, deklaratësë së propozueses dhe provave të tjera të cilat gjinden në shkresat e lëndës ka gjetur Sh. (L.) D. nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut, ka vdekur me datën 10.11.1982.

Prandaj gjykata duke i pasë për bazë këto fakte të konstatuara si dhe konform nenint 21 të Urdhëresës Administrative 24/215/ARC.MPB dhe konform neneve 73 dhe 74 të Ligjit të procedurës jokontestimore vendosi si më lartë.

Ky aktvendim është i formës së prerë që nga data 20.08.2024, sepse propozuesja ka hequr dorë nga e drejta e ankesës, ndërsa sa i përket shpenzimeve gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Nga arsyet e përmendura si dhe konform dispozites së lartëcekur është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega në Kaçanik

2022:220264 e datës 20.08.2024

Gjyqtari

Burhan Berisha.